



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 40

Datë: **23. 08. 2024** ora: 13:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Ilir Gashi, Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Alban Krasniqi, Sami Hamiti, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Fazli Stollaj, Qemalj Kurtis, Mufera Shinik.

Burim Ahmetaj, krye shef i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr. 38 dhe 39/2024
2. Shqyrtimi dhe miratimi i draft Rregullores Nr. 17/2024 Regjistrimi Dhe Votimi Jashtë Kosovës
- 3. Raport i Këshillave të KQZ**

4.1.Këshilli për Personel

1. Shqyrtimi dhe miratimi Listës së kandidatëve potencial për anëtar të komisionit të pranimit për pozitat:

Expert për Kontroll Financiar në ZRCKFSP

Expert i Bazës së të Dhënave në ZRCKFSP

Zyrtar i Lartë i Personelit në SKQZ

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Kërkesës për angazhimin e përkohshëm për pozitën e Asistentit për anëtar të KQZ-së

4.2. Këshilli për Buxhet dhe Financa

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të buxhetit dhe shpenzimet për periudhën janar- qershor 2024,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të shpenzimeve të derivateve për periudhën janar-qershor 2024,
3. Informim dhe Raportim të prokurimit për periudhën janar- qershor 2024.

4.3. Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për Platformën për “Edukimin, Informimin e Votuesve dhe Trajnimin”
2. Raport njoftues për ndërrimin e qendrës së votimit, për periudhën janar – qershor 2024;
3. Njoftim për përgatitjen e 5 videospoteve informuese për publikim lidhur me aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor; ;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për (bllomba) lidhëse të sigurisë për kutitë e votimit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për vula, jastëk vule dhe ngjyre jastëku të fletëvotimeve për zgjedhje
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Kërkesës për material administrativ për pakot e vendvotimeve për zgjedhje;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave për kuti të votimit;

4.4. Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ftesës nga Rrjeti i Institucioneve Elektorale Nacionale Frankofone-RECEF për pjesëmarrje në seminar në Cotonou, Benin.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i ftesës nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES) për Programin Zgjedhor të SHBA.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i ftesës së A-ËEB dhe Regjistrimit Civil Kombëtar të Kolumbisë për pjesëmarrje në Mbledhjen e 6-të të Asamblesë së Përgjithshme të A-ËEB dhe Javën e Demokracisë në Bogota, Kolumbi

5. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kryetari Radoniqi e hapi mbledhjen e radhës dhe, pasqyroi agjendën. Përgjatë prezantimit të agjendës, z. Radoniqi propozoi që të ketë një rirenditje: të fillohet me KOZ-in, pastaj Këshillin për Buxhet dhe me fillue mandej me Këshillin për Personel, dhe Këshillin për Marrëdhënie me Jashtë – si pika të mbyllura. Agjenda është e gjatë, dhe nëse keni diçka për agjendën dhe propozimin tim ? Nëse jo, e miratojmë. Agjenda e mbledhjes, u miratua me 10 vota për.

Në vazhdim, u miratuan procesverbalet nr. 38 dhe 39/2024.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i draft Rregullores Nr. 17/2024 Regjistrimi Dhe Votimi Jashtë Kosovës:

Kreshnik Radoniqi: Kemi punuar mjaft, është përkthyer në gjuhën serbe. A ka dikush diçka...?

Sami Kurteshi, tha se e ka lexuar rregulloren dhe se, ka ndoshta çështje gjuhësore, teknike...! Dhe, këtu është rregullorja me nr. 6, kjo renditje sa di unë, nuk është...! Kreshnik Radoniqi, tha se në renditje me rregulloret tjera, duhet të jetë rregullorja nr. 17.

Arianit Elshani, falënderoi të gjithë ata që kanë marrë pjesë në hartimin e kësaj rregullore, stafin e Sekretariatit, shërbimit votues që ka qenë shumë i përfshirë. Ky është një akt, një dokument shumë i rëndësishëm. Kjo rregullore, njëherë e mirë rregullon gjithë procedurat e votimit nga jashtë: mënyrën e regjistrimit dhe mënyrën e votimit në ambasada, në konsullata, votimin përmes postës në ambasada, dhe votimin përmes postës në Kosovë. Procedurat tjera, mbeten që ti shqyrtojmë dhe vendosim ne përgjatë procesit zgjedhor...

Alban Krasniqi: Natyrisht, mbetet që t'i rregullojmë dy çështje që duhet ti kemi parasysht. Kjo ka obligime për ne dhe institucionet tjera. Sekretariati duhet ti ndërmarrë të gjitha veprimet që ti shoh cilat janë

veprimet tona konkrete, që ne të jemi të gatshëm në operacionalizimin e detyrave tona. Na mbetet që ta kemi një draft me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe ti ndajmë përgjegjësitë, dhe ti dimë obligimit tona...!

Myfera Shiniq: Falënderoj ata që kanë punua në këtë rregullore, ama neni 12, ika 2: “Përbërja e anëtarëve të KVV-së, duhet të reflektojë subjektet politike të përfaqësuar në Kuvend që i janë nënshtruar pragut.” Komunitetet jo shumicë, i kanë vendet e garantuara. Nëse mundemi me ndryshua...

Gordana Llaban: Po pyes nëse ne jashtë dërgojmë përfaqësues, si do ti organizojmë anëtarët e komisioneve? Secila parti do të dërgojë përfaqësues, partitë shumicë apo qysh...?

Alban Krasniqi, tha se kolegët duhet ti lexojnë dokumentet se qysh rregullohet përfaqësimi, rregulloret që e rregullojnë çështjen e përfaqësimit. Edhe në zgjedhjet e kaluara, nuk ka pasur raste që ka pas përfaqësues të partive tjera, e të mos ketë të komuniteteve që jetojnë në atë Vendvotim. Janë dy elemente që duhet pasur parasysh! Është numri i KVV, që lidhet ngushtë me funksionet që i kryejnë gjatë ditës. Edhe ligji, e ka rregullue mënyrën e përfaqësimit të subjekteve politike në KVV. Themi kështu: nëse kemi një komunitet në Turqi, në këtë rast, ne duhet të kemi parasysh që atje të jetë një përfaqësues i komunitetit turk. Apo, në cilën do QV që numri i votuesve është i dallueshëm.

Ata, do të aplikojnë për votim, ne i shohim emrat dhe e dimë se kush do të votojë. Ne, jemi këtu për t'i rregullue çështjet. Ne, e kemi edhe rregulloren që i rregullon këto çështje...!

Po, ne kemi parasysh edhe kushtet, mundësitë dhe ne duhet ta kemi ligjin referencë, rregulloret...

Kreshnik Radoniqi: Kjo, dispozitë është e marrur prej ligjit, por në asnjë mënyrë askujt nuk i mohohet asnjë pjesëtar i të komuniteteve që të jenë pjesë e VV-ve. Askujt nuk i cenohet e drejta, por janë ligjet, rregullat se si rregullohet kjo...

Ilir Gashi: E përshëndes momentin që ne e kemi këtë rregullore për miratim. Por unë, tha z. Gashi, e kam një dilemë nëse është dashur me pas një afat të caktuar në rregullore tek neni 10, pika 6a 10 ku thotë se “Materialet dërgohen te operatori deri në një moment të dorëzimit”. Domethënë, cili është momenti i dorëzimit kur janë momentet, afatet e caktuara deri kur materialet vijnë në Kosovë...? Nuk po e di bazën ligjore të Ministrisë së Jashtme, por qëndrimi i materialeve atje duhet ta ketë një afat se, kur dorëzohen materialet.

Sami Kurteshi: Mirë është me i marrë parasysh vërejtjet, paqartësitë! Të gjitha. Por, unë mendoj se një çështje tjetër se, kemi njëfarë mënyrë te neni 12, pika 2: këtu, kemi njëfarë tautologjie...! Eh, këtu me të

drejtë kolegia e kupton si njëfarë përjashtimi. Mirëpo, është referencë rregullorja, pra me u thirrë në rregullore se si kjo është e paraparë. Mund të korrigjohet kjo pikë...

Kemi diskutua gjatë, dhe ne mendojmë se nga subjektet politike mund të kërkojmë atje që të jenë anëtarë. Ata, për para nuk e bajnë, por ne mendojmë se e kanë vullnetin. Është rregullorja për KVV-të, është njëfarë çelësi dhe besoj është rregulluar mirë. Kemi diskutue edhe me ministrinë e diasporës, por edhe kemi shqyrtue edhe të tjera çështje. Edhe diskutimet se qysh, kur, si mund ti pranojmë e marrim fletëvotimet...

Qemailj Kurtis: Ka pasur shumë angazhim. Unë, jam i përcaktuar në proces, dhe duhet theksuar se 50 % e elektoratit tonë është jashtë vendit. Është me rëndësi që ata të përfshihen. Para nesh, ende kemi të punojmë sepse, mund të shfaqen probleme dhe se duhet të mobilizohemi qysh tash që kjo të shkojë perfekt. Edhe unë mendoj që neni 12, është i diskutueshëm. Nëse mbetet kështu, të tjerët nuk përfshihen.

Arianit Elshani: Ne, me të vërtetë në rregullore që i bëjmë ne, mund edhe ti përmirësojmë, korrigjojmë por atë që e ka parapa ligji, ne nuk mund ta ndryshojmë. Këtë, mund ta bëjnë vetëm deputetet! Vetëm ata mund ta ndryshojnë. Saktë e pa parapa; 3- 5 anëtarë në këshillat e KVV. Por, thotë edhe se kudo që mund të bëhet, të përfaqësohen nga grupet parlamentare që janë pjesë e kuvendit. Në vazhdim, z. Elshani tha se KQZ, është ajo që i jep çdo procesit zgjedhor dhe kjo ka ndodh ku në shumë komuna ku ka pas kërkesë prej komunitetit, është marrë në konsideratë zëri i tyre! Realisht, KQZ është këtu për ti dhënë sa më shumë legjitimitet procesit zgjedhor. Kemi shembuj ku, edhe partitë tona nuk dërgojnë komisionar duke u lënë sa më shumë hapësirë komuniteteve në komuna të caktuara.

Nuk kemi nevojë ta prekim ligjin. Ne, nuk e dimë sa parti politike do ti kemi të certifikuar. T'ia lëmë kohës, ne jemi këtu, edhe ene marrim vendime. Parimisht, sot mendoj që duhet të jetë gjithëcka në bazë të ligjit. Edhe Iliri e shtroi pyetjen, por ne e kemi lënë ashtu sepse nuk e dimë sasinë e zarfeve që të pranohen, dhe për mos me rritë volumin e përgjegjësive e kemi lënë të hapur periodikisht. Posta na njofton sa zarfe duhet marrë, dhe shërbimi votues është këtu. E hëna, është dita e fundit kur zarfet, të gjitha duhet të hidhen në postë...Nuk ka afat tjetër...

Në vazhdim, në këtë pikë diskutua sërish: Myfera Shinik, Fazli Stollaj, Alban Krasniqi, Kreshnik Radoniqi, Arinait Elshani, Ibrahim Selmanaj i cili, tha se ndoshta duhet ta kemi një plan shpjegues, paraprakishtë. Pastaj, diskutoi edhe Alban Krasniqi, Ilir Gashi. Në fund, pas një analize substanciale gjithëpërfshirëse, u bë një ndryshim u vogël te neni 12, paragrafi 2, ku u vendos të procedohet sipas nenit 74: neni "Përbërja e anëtarëve të KVV, rregullohet sipas nenit 74, paragrafi 11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme."

Me 10 vota për (përgjatë momentit të votimit mungoi Ilir Gashi) , anëtarët e KQZ-së miratuan **Rregulloren 17/2024 Regjistrimi Dhe Votimi Jashtë Kosovës.**

4.2.Këshilli për Buxhet dhe Financa

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të buxhetit dhe shpenzimet për periudhën janar- qershor 2024:

Gordana Llaban, tha se në takimin e 12-të të këshillit, të mbajtur me 18 korrik, është shqyrtuar raporti i buxhetit dhe i shpenzimeve për periudhën: janar- qershor 2024. Buxheti i KQZ ka arritur këtë vit në 10 milion 126, 498 euro. Ajo pastaj, raportoi për shpenzimet e KQZ në shifra, në kategori. Ne, në këshill i kemi miratuar këtë raport, dhe rekomandojmë për miratim.

Sami Hamiti, tha se raporti është debatuar. Është raport i saktë, por kishim një çështje të shpenzimeve që lidhen me aktivitetet. Po flas për mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale. Por, nuk kemi investime kapitale. Premtimet i kemi nga Sekretariati që, do të përmirësohen shpenzimet në fillim të vitit të ardhshëm...

Me 10 vota për, anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë raport.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të shpenzimeve të derivateve për periudhën janar-qershor 2024:

Gordana Llaban, gjithashtu raportoi lidhur me shpenzimet e derivateve për periudhën janar-qershor 2024 që tha të kenë qenë 12 automjete të KQZ, dhe nga muaji prill 2 automjete private. Janë shpenzuar në sasi prej: 8, 098 litra lëndë djegëse. Znj. Llaban, pasqyroi itinerarin e kilometrave të bëra, ashtu si edhe sasinë e shpenzuar të lëndës djegëse në 100 kilometra.

Anëtarët e KQZ me 10 vota për, miratuan këtë raport.

Në këtë pikë, diskutuan: Sami Hamiti dhe Arianit Elshani dhe Alban Krasniqi të cilët, e cilësuan raportin në rregull dhe se, ishte mendimi i pozitës në të cilat, tashmë ndodhen disa makina. Ato, janë pothuajse jashtë përdorimit, dhe paraqesin rrezik të përdorimit të mëtejshëm. Diskutoi edhe Burim Ahmetaj që tha se me rishikimin e planit të prokurimit, disa aktivitete ende nuk kanë fillue. Ai, pasqyroi aktivitetet që janë në proces, dhe disa të tjerat ende nuk kanë filluar...Ai, tha se realizimi i tyre merr kohë për shkak të procedurave ligjore.

Ky raport, me rekomandime u miratua me 11 vota për...

3. Informim dhe Raportim të prokurimit për periudhën janar- qershor 2024:

Në këtë pikë, referoi Burim Ahmetaj. Ai tha se, raporti paraqet aktivitetet janar – qershor 2024. Janë disa aktivitete që ende nuk kanë fillue. Kjo, me rishikimin e planit të prokurimit. Ai pastaj, tha se edhe te mallrat dhe shërbimet niveli i shpenzimeve është i ulët. Z. Ahmetaj, pasqyroj aktivitetet që janë krye, si dhe të tjerat janë në proces të miratimit të specifikave. Ai, tha se realizimi i tyre merre kohë për shkak të procedurave ligjore. Nuk shohim që ndonjë aktivitet rrezikohet të shtyhet deri në tetor apo nëntor sepse, mendojmë t’i realizojmë përpara...

4.3.Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për Platformën për “Edukimin, Informimin e Votuesve dhe Trajnimin”:

Arianit Elshani, tha se KOZ e ka shqyrtuar kërkesën për miratimin e planit të veprimit për Platformën për Informim dhe Edukim të Votuesve dhe Trajnimin. Kjo platformë, është në anën tonë. Është e varur nga ne. I gjithë procesi, duhet të kryhet deri më 6 shtator, trajnimi i komisionarëve, informimi dhe edukimi i votuesve, mbi mënyrën dhe ecurinë e votimit, si dhe çështjet e tjera procedurale të KQZ-së. Deri më datën 2 gusht, Sekretariati do të zhvillojë përmbajtjen e kësaj platforme...

Lidhur me platformën, deri më 23 gusht operatori do ti realizoj tri module: Edukimin e votuesve, Trajnimin e administratës së zgjedhjeve dhe modulën e Trajnimit për vëzhgues. Më 30 gusht, do të testohet platforma, dhe nga 6 shtatori do të fillojë zbatimi i saj...

Ka edhe faza të tjera, dhe mendojmë se e gjitha do ta lehtësoj shumë procesin.

Me 11 vota për, u miratua Plani i veprimit i Platformës për “Edukimin, Informimin e Votuesve dhe Trajnimin”.

2. Raport njoftues për ndërrimin e qendrës së votimit, për periudhën janar – qershor 2024:

Arianit Elshani: KOZ, tha z. Elshani është njoftuar me raportin e ndërrimit të QV-e. Gjithsej, përkundër gjithë fushatës 489 qytetarë. Nga këta: 452 kërkesa janë aprovuar. Z. Elshani, gjykoj se kjo është pak, dhe

se ai konstatoi se duhet ndërmarrë veprime informuese, mënyra të reja për adresimin ndryshe të kësaj çështje..

3.Njoftim për përgatitjen e 5 videospoteve informuese për publikim lidhur me aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor:

Arianit Elshani: Jemi njoftuar për përgatitjen e 5 videospoteve informuese lidhur me aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor. Ishte ide dhe realizim i zëdhënësit, dhe se konsiderojmë që edhe të tjerët të kenë inisiativa të këtilla.

Alban Krasniqi: Mendoj që videot, duhet me u miratue nga KQZ...

Nuk ka incizim të mëtejshëm, deri në minutën 1:18:12.

Ilir Gashi: Mendoj që për dhjetshën e parë është sugjестive, është dashur bile edhe nja 10 sekonda më shumë që, të mos mbetet vetëm “numri 10”. Pra, edhe një fjali është dashur të shtohet, dhe kjo përbënë mangësi...

Me 9 vota për, u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Në vazhdim të mbledhjes, u shqyrtuan dhe u miratuan edhe këto pika, për të cilat kryesuesi i KOZ-it z. Elshani, si zakonisht në raportet e tij pasqyroi në detaje të “përmbajtjet” që lidhen me këto pika të cilat, edhe u miratuan nga KQZ:

4.Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për (bllomba) lidhëse të sigurisë për kutitë e votimit (u miratua me 10 vota për).

5.Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për vula, jastëk vule dhe ngjyre jastëku te fletëvotimeve për zgjedhje (u miratua me 10 vota për).

6.Shqyrtimi dhe miratimi i Kërkesës për material administrativ për pakot e vendvotimeve për zgjedhje (u miratua me 10 vota për).

7.Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave për kuti të votimit (me 10 vota për, u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës).

1. Raport i Këshillave të KQZ

4.1. Këshilli për Personel

1. Shqyrtimi dhe miratimi Listës së kandidatëve potencial për anëtar të komisionit të pranimi për pozitat:

Alban Krasniqi: E kemi marrë një njoftim që nuk është si pikë e rendit nga udhëheqja e personelit dhe ka kërkuar rekomandim, ngase për pozitën e drejtorit ekspertët që kanë aplikuar nuk i kanë plotësuar kriteret. E kemi marrë edhe opinionin e ekspertit, dhe ai ka thënë se nuk ka nevojë për rekomandim me e shpallë nga KQZ. Ka thënë që, nuk është mirë me e vazhdue...Ka mbetur edhe sot të punohet që, vërejtjet e udhëheqëses së personelit të shpjegohen më shumë për 'ekspertët' që nuk i kanë plotësuar kushtet...

2.Shqyrtimi dhe miratimi i Kërkesës për angazhimin e përkohshëm për pozitën e Asistentit për anëtar të KQZ-së

Gjithashtu, është edhe kërkesa e Sekretariatit për shpalljen e një konkursi të përkohshëm për një asistent për anëtarin e KQZ dhe që kërkon miratimin tonë. E kemi diskutuar edhe më parë, dhe tani është koha ta shpallim konkursin dhe ta miratojmë këtë kërkesë...

Me 11 vota për, u miratua kjo kërkesë.

Alban Krasniqi:Miratimi i paneleve të rekrutimit për pozitat e ndryshme, komisionet e pranimi dhe lista e institucioneve që dërgojnë për rekrutime miratohen nga KQZ. Listat, shkojnë te njësia e burimeve njerëzore që i futë në 'përzgjedhjen e rastësishme'. Këto panele për shembull, për pozitën ekspert për kontrollin financiarë, zgjidhet për dy vite...

Ne, e kemi idenë që të dërgohen ftesat te sa më shumë institucione sepse, kjo mundëson që ne të kemi më shumë kandidat për tu përzgjedhur...Është sfidë, sepse institucionet nuk dërgojnë përfaqësues, i vonojnë por edhe ne, duhet ta rrisim komunikimin...

Ju, e keni njoftimin lidhur me komisionin për pranim të Expertit për Kontroll Financiar në ZRCKFSP...!

Pas shpjegimit të procedurave të formimit të komisionit, z. Krasniqi kërkoi miratimin e anëtarëve të KQZ.

Me 11 vota për, miratohet. Me vota të njëjta, u miratuan edhe komisionit për:

Expert i Bazës së të Dhënave në ZRCKFSP

Zyrtar i Lartë i Personelit në SKQZ

4.4.Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë

Kreshnik Radoniqi: I kemi tri pika, por një të kemi hequr...! Pika e parë, është: 1. Shqyrtimi dhe miratimi i ftesës nga Rrjeti i Institucioneve Elektorale Nacionale Frankofone-RECEF për pjesëmarrje në seminar në Cotonou, Benin. Ne, në këshill konsideruam se nuk kemi kandidatë, dhe se nuk kemi as pse ta miratojmë...

2. Shqyrtimi dhe miratimi i ftesës nga Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES) për Programin Zgjedhor të SHBA:

Kreshnik Radoniqi: Kemi komunikua me IFES lidhur me atë se, a mundën ata të na ndihmojnë...Ende nuk kemi përgjigje. Po mendojmë që kjo pikë të shtyhet...

3. Shqyrtimi dhe miratimi i ftesës së A-WEB dhe Regjistrimit Civil Kombëtar të Kolumbisë për pjesëmarrje në Mbledhjen e 6-të të Asamblesë së Përgjithshme të A-WEB dhe Javën e Demokracisë në Bogota, Kolumbi:

Kreshnik Radoniqi: E kemi shqyrtuar edhe ftesën e AWEB-it dhe Regjistrimit Civil Kombëtar të Kolumbisë për pjesëmarrje në Mbledhjen e 6-të të Asamblesë së Përgjithshme të A-WEB dhe Javën e Demokracisë në Bogota, Kolumbi. Kemi shprehur dëshirën të marrim pjesë. Pjesëmarrja, pjesërisht është e paguar nga AWEB, pjesën tjetër e plotësojmë ne. Rrugën, e paguajmë ne. Këshilli, propozoi që të shkojmë unë dhe Arianiti, por nëse ka të tjera propozime, urdhëroni...

Me 11 vota për, u miratua ky propozim.

5. Të ndryshme